



REPUBLIKA E SHQIPERISË

SHOQERIA RAJONALE UJESJELLES KANALIZIME KUKES SH.A

Nr. _____ Prot.

Kukës, me ____ / ____ / 2026

Shtojca 12.

**FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT FILLOJNË
AFATET E ANKIMIMIT**

Date: 17 .09.2026

Drejtuar Operatorit Ekonomik : “KRONOS KONSTRUKSION” SHPK

Adresa: Bulevardi Gjergj Fishta,, Prane ish ekspozites Shqiperia Sot, Tirane

Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE): KRONOS KONSTRUKSION SHPK me

NIPT:K41416033P dhe Adrese: Bulevardi Gjergj Fishta,, Prane ish ekspozites Shqiperia Sot,
Tirane

- OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ **JO** ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐ **JO** ☒

Nëse po, të jepen dhënat:

[Emrat, Nipt-et, përkatëse dhe adresat]

Tipi i Kontratës: **Pune**

Lloji i Procedurës së prokurimit: **“E Hapur - Punë”**,

Numri i Procedurës / referenca e Lotit: **REF-93931-07-20-2026**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **“Rehabilitimi Kolektoreve te KUZ ne Qytetin e Kukës, Bashkia Kukës”, dhe kohe zgjatje 12 muaj nga momenti i fillimit te zbatimit te kontrates.**

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: **21.07.2026.**

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletin e Njoftimeve Publike [Data] [Numri]Buletini
NR.47 DATE 27.07.2026..

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- oferta ekonomike më e favorshme bazuar në kosto X
- oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Formulari ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë, Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1.Bashkimi i opertaoreve ekonomik:

“DENOLT “ Shpk	K48021210Q
“DRINI-1”Shpk	J78716317H
“SELAMI”Shpk	J77304706L

Vlera :60,152,232.00 {Gjashtdhjetë milion e njëqind e pesëdhjetë e dy mijë e dyqind e tridhjetë e dy} Leke pa TVSH.

Vlera: 72,182,678.40 [Shtatëdhjetë e dy milionë e njëqind e tetëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e tetë pikë dyzet] Leke me TVSH.

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

2. Bashkimi i operatoreve ekonomik

”Griald”shpk	J68117216C
“Ina” shpk	J61814009W

Vlera: 73,903,704 {Shtatëdhjetë e tre milion e nentëqind e tre mijë e shatëqind e kater} Leke pa TVSH.

Vlera:88,684,445{Tetëdhjetë e tete milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e kater mijë e katerqind e dyzet e pese} leke me TVSH.

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

3. Bashkimi i operatoreve ekonomik

”IDEAL CONSTRUCTION AND PROJECTION {I.C.P} Sh.p.k

L91310511L

“LIQENI VII”sh.p.kK01730502W

Vlera: 84,172,751.25 {Tetëdhjetë e katër milion e njëqind e shtatëdhjetë e dy e pesëdhjetë e një leke pike njëzet e pesë} Leke pa TVSH

Vlera: 101, 007, 301.50 {Njëqind e një milion e shtatë mijë e treqind e një leke pike pesëdhjetë} Leke me TVSH

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

4. Bashkimi i operatoreve ekonomik

”Kevin Konstruksion”sh.p.k

K71401004W

“NIKA” sh.p.k

J76705047U

Vlera :78,189,562.50 { Shtatëdhjetë e tetë milion e njëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e dy pike pesëdhjetë} Leke pa TVSH.

Vlera: 93,827,475.00{ Nëntëdhjetë e tre milion e tetëqind e njëzet e shtatë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e pesë pike zero } Leke me TVSH.

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

5. Operatori ekonomik

”Kronos Konstruksion” shpk

K41416033P

Vlera :92,891,281.35 { Nëntëdhjetë e dy milion e tetëqind e nëntëdhjetë e një mijë e dyqind e tetëdhjetë e një pike tridhjetë e pesë } Leke pa TVSH.

Vlera: 111,469,537.62 { Njëqind e njëmbëdhjetë milion e katërqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind e tridhjetë e shtatë pike gjashtëdhjetë e dy } Leke me TVSH.

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO x

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

6. Operatori ekonomik

“NDERGJONI”Sh.p.k

K31329048I

Vlera :65,006,001 {Gjatedhjete e pese milion e gjashte mije e nje} Leke pa TVSH.

Vlera: 78,007,201 {Shtatedhjete e tete milion e shtate mije e dyqind e nje}Leke me TVSH.

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO x

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Etj. _____

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar, Ofertuesit e mëposhtëm:

1.. Bashkimi i operatoreve ekonomik

“DENOLT “ ShpkK48021210Q

“DRINI-1”Shpk

J78716317H

“SELAMI”Shpk

J77304706L

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Nga shqyrtimi i kontratave që jane ngarkuar nga operatorëve ekonomik rezulton se nje pjese e kosiderueshme e kontratave të paraqitura nga operatori DRINI -1 shpk janë të hartuara dhe ekzekutuara si kontrata shërbimi për mirëmbajtje rutinë/dimërore, ndërsa kriteri 2.3.1 që ke sjellë kërkon shprehimisht “punë të ngjashme” dhe dokumente tipike të kontratave të punëve; së dyti, edhe nëse këto kontrata do të pranoheshin materialisht si përvojë e ngjashme,

dokumentacioni që shohim nuk individualizon qartë se cilat zëra dhe çfarë vlere ka realizuar konkretisht DRINI-1 sh.p.k. si anëtar me 40% të BOE-së.

Kontratat e paraqitura janë kontrata shërbimi, jo kontrata punësh

Vetë dokumentacioni i paraqitur e përcakton natyrën juridike të objektit. Në kushtet e përgjithshme të kontratave, “Shërbime” përkufizohen si detyrat që duhet të kryhen nga kontraktuesi, ndërsa objekti përshkruhet si kryerja e shërbimeve të mirëmbajtjes. Për më tepër, faturat elektronike përdorin kategorinë “Përshkrimi i Mallit ose Shërbimit” dhe në dokumentacionin e kontratës nr. 89 evidentohet edhe shprehimisht “Shërbim”.

Kjo përputhet edhe me Ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Ligji dallon kontratën publike për punë nga kontrata publike për shërbime dhe përcakton se kontratat publike për shërbime janë ato që kanë objekt kryerjen e shërbimeve të tjera nga ato që hyjnë në përkufizimin e kontratave të punëve.

Në vlerësim të kriterit të autoritetit kontraktor është kërkuar që për të provuar punën e ngjashme operatorët ekonomik duhet të paraqesin si më poshtë:

1. Kontratën e Sipërmarrjes
2. Formularin e Vlerësimit
3. Situacionin Përfundimtar
4. Faturat tatimore
5. **Aktin e Kolaudimit**
6. Certifikatën e marrjes në dorëzim

Në materialet e ngarkuara, ndërkohë, shohim dokumente të administrimit të kontratës së mirëmbajtjes: situacione mujore/përfundimtare, procesverbale/certifikime të shërbimeve, faturim etj.

Dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik për përmbushjen e kriterit 2.3.1 nuk provon në mënyrë të plotë dhe të individualizuar përvojën e suksesshme në “punë të ngjashme”. Kontratat e paraqitura kanë objekt “Mirëmbajtje rutinë dhe dimërore me performancë” dhe nga vetë dokumentacioni i paraqitur rezultojnë të trajtuara si kontrata shërbimi. Për rrjedhojë, ato nuk mund të barazohen automatikisht me kontrata punësh vetëm për qëllim të përmbushjes së kriterit të eksperiencës së ngjashme, pa u provuar natyra e punimeve konkrete që pretendohet se janë të ngjashme me objektin e procedurës.

Për më tepër, kriteri kërkon Akt Kolaudimi dhe Certifikatë të Marrjes në Dorëzim si dokumentacion provues për kontratat publike të punëve. Kontratat e referencës, duke qenë kontrata shërbimi mirëmbajtjeje, janë administruar nëpërmjet situacioneve dhe certifikimeve periodike të shërbimit. Mungesa e dokumentacionit të kërkuar nuk mund të plotësojë kriterin e kërkuar nga AK.

Në zbatim të nenit 88 në rastet e BOE kapacitetet lidhen me përqindjen dhe pjesën që secili anëtar merr përsipër, jo thjesht me faktin se emri i tij figuron në një kontratë të përbashkët. Në dokumente të tjera zyrtare të APP-së gjendet po kjo logjikë, pra plotësimi nga secili anëtar “në raport me përqindjen dhe/ose elementët që merr përsipër të realizojë”.

Kontrata e paraqitura nga operatori ekonomik janë kontrata shërbimi dhe nuk kualifikohen si “punë të ngjashme”; ose trajtohen si kontrata punësh për kriterin 2.3.1.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur rezulton se kontratat e referencës kanë objekt “Mirëmbajtje Rutinë dhe Dimërore me performancë” dhe, për nga natyra, mënyra e ekzekutimit dhe dokumentacioni i faturimit, janë kontrata shërbimi. Vetë dokumentacioni fiskal i paraqitur i referohet objektit si “Shërbim”, ndërsa realizimi i kontratave është dokumentuar nëpërmjet situacioneve dhe faturimeve periodike.

Pikërisht për shkak të natyrës së tyre si kontrata shërbimi, këto kontrata nuk shoqërohen me Akt Kolaudimi. Mungesa e këtij dokumenti përbën një mangësi, e cila vjen si pasojë e natyrës juridike dhe teknike të kontratave të paraqitura, të cilat nuk kanë si rezultat përfundimin e një vepre ndërtimore që i nënshtrohet kolaudimit, por ofrimin periodik dhe të vazhdueshëm të shërbimeve të mirëmbajtjes.

Në vlerësim të kontratave të tjera të paraqitura nga ky operator ekonomik si më poshtë:

Kontrata	Vlera e realizuar pa TVSH	Pjesa DRINI-1	Vlera që i takon DRINI-1
Ndërhyrje në tunelin e Gojanit / masa inxhinierike	14,223,144.17	55%	7,822,729.29 lekë
Rikonstruksion i Qendrës Rinore, Pukë	4,700,084.00	100%	4,700,084.00 lekë
Trotuar dhe ndriçim Rotondo–Gjykata, Pukë	1,754,606.67	100%	1,754,606.67 lekë

Riparim/mirëmbajtje rrugësh të brendshme, Spitali Shkodër	7,566,325.00	100%	7,566,325.00 lekë
Kanalizime ujërash të ndotura, Berat	11,822,827.50	46%	5,438,500.65 lekë
TOTAL DRINI-1			27,282,245.61 lekë

Rezulton se bazuar ne % e marr përsipër nga operatori ekonomik DRINI -1 shpk konkretisht 22.94% duhet te plotësonte pikën b) e cila është

- b) *punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.*

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Komisioni i vlerësimit të ofertave në vlerësim të kontratave të paraqitura nga operatori ekonomik rezulton, se operatori ekonomik nuk ka arritur të dëshmojë, se ka kryer kontrata të mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimit, në vlerën e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, pasi zërat e konsideruar të ngjashëm nuk përmbushin dhe nuk e tejkalojnë vlerën prej $(200\% \text{ vl së FL, pra } 100 \text{ 013 185 } * 200\% = 200 \text{ 026 } 370 * 22.94\% = 45,886,049.3 \text{ lekë pa TVSh})$, sipas kërkesës së autoritetit kontraktor.

Komisioni konstaton, se nuk përputhet elementi natyrë e ngjashme, pasi nuk bazohet në natyrën, kompleksitetin ose karakteristika të tjera të përshkruara në raportin teknik. Punimet në investimet në rrjetin elektrik, janë dy kategori punimesh të ndryshme. Pra, si përfundim, këto kontrata nuk mund të konsiderohen aspak kontrata me natyrë të ngjashme, me objektin e prokurimit.

Operatori ekonomik “DRINI 1” shpk bazuar në llogaritjen e sipërcituar të kryer nga komisioni mbështetur në kriterin e kërkuar nga AK në zbatim të legjislacionit të prokurimit publik ka konstatuar se OE nuk plotëson as pikën b) të kriterit për punën e ngjashme.

Rrjedhimisht, ky kriter nuk do të konsiderohet i përmbushur nga operatori ekonomik ” DRINI 1” SHPK. KVO gjykon, se kriteret për kualifikim i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron eksperiencat e mëparshme të

ngjashme me objektin e prokurimi por, edhe në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentet e tenderit.

Komisioni i vlerësimit të ofertave gjykon, se kriteret për kualifikim i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron eksperiencat e mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimi por, edhe në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentet e tenderit. Pra, për të plotësuar pikën e mësipërme të kërkesave për kualifikim për eksperiencën e ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, pasi për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron eksperiencat e mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimi por, edhe në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentet e tenderit. Sa më sipër, KVO konstaton, se me dokumentacionin e paraqitur, bashkimi i operatorëve ekonomik , operatori ekonomik DRINI 1 shpk vërteton nuk se plotëson kriterin 2.3.1 b) të kapacitetit teknik të dokumenteve të tenderit në raport me përqindjen e marr përsipër në kontratën e bashkëpunimit.

Pra, për të plotësuar pikën e mësipërme të kërkesave për kualifikim për eksperiencën e ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, pasi për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron eksperiencat e mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimi por, edhe në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentet e tenderit. Sa më sipër, KVO konstaton, se me dokumentacionin e paraqitur, operatori ekonomik vërteton nuk se plotëson kriterin 2.3.1/b të kapacitetit teknik të dokumenteve të tenderit.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave për shkak të ekonomicitetit procedural ka vlerësuar të panevojshëm vijimin e verifikimit të dokumentacionit të operatorit ekonomik, duke qënë se përsëri statusi juridik i këtij operatori do të mbetet i s'kualifikuar.

Bazuar në Nenin 92 paragrafi 3 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar me Ligjin Nr.16 datë 08.02.2024 ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, **Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pranë Autoritetit Kontraktor bëri s'kualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomik shoqëria “DRINI-1” sh.p.k, me NIPT J78716317H & “SELAMI” sh.p.k me NIPT J77304706L dhe shoqëria “DENOLT” sh.p.k. me NIPT K48021210Q.**

2. Bashkimi i operatoreve ekonomik

''Griald''shpk

J68117216C

'Ina'' shpk

J61814009W

* * *

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐

JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Në vlerësim të dokumentacionit të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomik komisioni i vlerësimit të ofertave rezulton si më poshtë:

Referuar puneve të ngjashme nga operatori ekonomik Griald shpK rezulton si më poshtë;

Për kontratën "Ndërtimi i ITUN, rrjetit të kanalizimeve të ujërave të zeza dhe ujësjellësit në Valbonë", marrëveshja e bashkëpunimit përcakton pjesëmarrjen: Vllaznimi 60% dhe GRIALD 40%. Vlera totale sipas preventivit është 47,494,273 lekë me TVSH, ndërsa pjesa e përcaktuar për GRIALD është 18,997,709 lekë me TVSH.

Pra, llogaritja është: $47,494,273 \times 40\% = 18,997,709.20$ lekë me TVSH

Ndërkohë, për kontratën tjetër "Rikonstruksioni i Kanalit Vadiës Ura Vigi i Vakës–Cerrnicë", GRIALD rezulton se e ka realizuar e vetme kontratën, me vlerë të realizuar 32,399,558.46 lekë me TVSH.

Vlera totale e kontratave të paraqitura nga operatori ekonomik GRIALD shpk si më poshtë të reflektuara:

Kontrata	Pjesa e GRIALD
ITUN Valbonë – 40%	18,997,709.20 lekë
Kanali Vadiës Cerrnicë – 100%	32,399,558.46 lekë
TOTALI	51,397,267.66 lekë me TVSH

Pra, nga këto dy kontrata, vlera e punimeve që i atribuohet GRIALD është 51,397,267.66 lekë me TVSH.

Nga shqyrtimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit të lidhur ndërmjet operatorëve ekonomikë "GRIALD" sh.p.k. dhe "INA" sh.p.k., rezulton se palët kanë përcaktuar në mënyrë të

shprehur se kriteri për punën e ngjashme sipas pikës 2.3.1/a do të përmbushet nga shoqëria “GRIALD” sh.p.k., në raport me përqindjen e saj të pjesëmarrjes në bashkim. Po sipas marrëveshjes, pjesëmarrja e secilit operator në zbatimin e kontratës është përcaktuar në masën 50%. Duke qenë se fondi limit i procedurës është 100,013,185 lekë pa TVSH, pjesa e kontratës që i korrespondon shoqërisë GRIALD, sipas përqindjes së marrë përsipër, është 50,006,592.50 lekë pa TVSH.

Në këto kushte, përderisa vetë bashkimi ka përcaktuar se GRIALD do të përmbushë alternativën “a” të kriterit 2.3.1, përmbushja e këtij kriteri duhet të provohet në përputhje me kërkesën specifike të pikës a), pra nëpërmjet një pune të ngjashme të realizuar për një objekt të vetëm dhe jo nëpërmjet mbledhjes së vlerave të disa kontratave të ndryshme. Kjo mënyrë vlerësimi është në përputhje edhe me nenin 39 pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, i cili trajton veçmas alternativën e punës së ngjashme për një objekt të vetëm nga alternativa e vlerës monetare totale të disa punëve të kryera.

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga GRIALD sh.p.k. nuk rezulton një kontratë e vetme e ngjashme që, në pjesën efektivisht të realizuar nga ky operator, të arrijë vlerën e nevojshme për përmbushjen e kriterit të marrë përsipër. Në kontratën për objektin “Ndërtimi i ITUN, rrjetit të kanalizimeve të ujërave të zeza dhe ujësjellësit në Valbonë”, GRIALD ka realizuar vetëm 40% të punimeve, me vlerë rreth 18,997,709 lekë me TVSH, ndërsa kontrata tjetër e paraqitur, e realizuar individualisht, ka një vlerë rreth 32.4 milionë lekë me TVSH. Për rrjedhojë, asnjë prej këtyre punëve, e marrë individualisht, nuk plotëson vlerën e kërkuar për një objekt të vetëm, dhe nuk plotëson kriterin e AK në pikën a të pikës 2.3.1 të kapacitetit teknik, puna e ngjashme.

Për sa më sipër operatori ekonomik GRIALD shpk nuk plotëson punën e ngjashme për këtë procedurë prokurimi.

Gjithashtu në vlerësim të dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik INA shpk për pikën 2.3.1 të punës së ngjashme e cila mund të plotësojë pikën a ose b) sipas kriterit si më poshtë

- a. *punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet (pa TVSH) dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*

Ose

- b. *Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është në një vlerë jo më të vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. (pa TVSH).*

Plotësimi i njërës prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Komisioni i vlerësimit të ofertave pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik INA shpk shqyrton si më poshtë:

Për operatorin ekonomik INA sh.p.k., me pjesëmarrje 50% në bashkimin e operatorëve ekonomikë, kërkesa sipas pikës 2.3.1/a përlogaritet duke marrë fillimisht 50% të fondit limit prej 100,013,185 lekë pa TVSH, që rezulton në 50,006,592.50 lekë, dhe më pas duke aplikuar përqindjen 50% të pjesëmarrjes së INA sh.p.k., duke rezultuar në një kërkesë minimale prej 50,006,592.50 lekë pa TVSH për një punë të vetme të ngjashme. Nga dokumentacioni i paraqitur rezulton se INA sh.p.k. ka realizuar objektin “Kanali Ujitës Polis Tudan” me vlerë rreth **46,699,190.83 lekë pa TVSH**, ndaj në aspektin monetar përmbush alternativën a).

Në rast se alternativa a) nuk përmbushet, sipas alternativës b) kërkesa do të ishte dyfishi i fondit limit në disa kontrata , pra **100,013,185 *200% =200,026,370 lekë pa TVSH**, dhe në raport me pjesëmarrjen 50% të INA sh.p.k. do të kërkohej një vlerë totale prej **100,013,185 lekë pa TVSH**, e realizuar në disa kontrata të ngjashme gjatë periudhës së kërkuar.

Përsa më sipër operatori ekonomik INA shpk nuk plotëson asnjë prej pikave të kriterit 2.3.1 të kapacitetit teknik, puna e ngjashme.

Ndodhur në këto kushte komisioni i vlerësimit të ofertave skualifikon bashkimin e operatorëve ekonomik.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave për shkak të ekonomicitetit procedural ka vlerësuar të panevojshëm vijimin e verifikimit të dokumentacionit të operatorit ekonomik, duke qënë se përsëri statusi juridik i këtij operatori do të mbetet i s’kualifikuar.

Bazuar në Nenin 92 paragrafi 3 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar me Ligjin Nr.16 datë 08.02.2024 ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, **Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pranë Autoritetit Kontraktor bëri s’kualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomik shoqëria GRIALD shpk me NIPT J68117216C dhe shoqëria INA shpk me NIPT J61814009W.**

3. Bashkimi i operatoreve ekonomik

”IDEAL CONSTRUCTION AND PROJECTION {I.C.P} Sh.p.k

L91310511L

“LIQENI VII”sh.p.k

K01730502W

OE/BOE me nënkontraktor

PO



JO

X

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Në vlerësim të dokumentacionit të paraqitur nga bashkimi i operatoreve ekonomik komisioni i vlerësimit të ofertave rezulton si më poshtë:

Nga vlerësimi i kontratave të ngjashme të paraqitura nga operatori ekonomik IDEAL CONSTRUCTION AND PROJEKTION (I.C.P) REZULTON SI MË POSHTË:

Në tabelë punët e ngjashme të paraqitura nga IDEAL CONSTRUCTION AND PROJECTION (I.C.P.) sh.p.k. dhe përqindjen (%) që operatori ka në secilën prej tyre:

Nr.	Objekti i punës së ngjashme	Forma e realizimit	% e ICP	Vlera e objektit / e realizuar	Pjesa e realizuar nga ICP
1	“Sistemi i trajtimit të ujërave të zeza në Lagjen e Re Spitallë”	BOE me “Balili Konstruksion”	10.1%	59,138,315.32 lekë me TVSH	5,972,969.85 lekë
2	“Rehabilitim Kanali Gjorm”	BOE me “Balili Konstruksion”	8%	18,206,801 lekë me TVSH	1,456,544.08 lekë
3	“Ndërtim rrjeti KUB dhe KUZ në objektin Dyrakium, Durrës”	Nënktraktor / kontratë private	100% e punimeve të kontratës së paraqitur	17,500,000 lekë pa TVSH	17,500,000 lekë pa TVSH
4	Punime për sistemime të jashtme dhe infrastrukturë elektrike/hidraulike – Spitallë (PROGEEN)	Nënktraktor	100% e kontratës së nënkontraktimit të paraqitur	43,229,811.50 lekë pa TVSH	43,229,811.50 lekë pa TVSH

5	“Ndërtim i Rrjetit të Kanalizimeve në Fshatin Rrushkull”	Kontratë e realizuar individualisht	100%	32,540,573.21 lekë pa TVSH	32,540,573.21 lekë pa TVSH
---	---	-------------------------------------	-------------	-----------------------------------	-----------------------------------

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur për kontratat ku shoqëria “IDEAL CONSTRUCTION AND PROJECTION (I.C.P.)” sh.p.k. deklarohet si nënkontraktor, konkretisht në kontratën me “DYRRAKIUM CONSTRUCTION COMPANY” sh.p.k. dhe në kontratën me “PROGEEN” sh.p.k., rezultojnë të paraqitura kontrata të lidhura ndërmjet subjekteve private, dokumente realizimi, situacione dhe fatura. Megjithatë, nga dokumentacioni i paraqitur nuk rezulton të jetë paraqitur miratimi zyrtar i Autoritetit Kontraktor për ICP sh.p.k. si nënkontraktor, si dhe nuk evidentohet dokumentacioni i plotë i kontratës bazë ndërmjet kontraktorit kryesor dhe Autoritetit Kontraktor, sipas kërkesës së pikës 2.3.1. Për rrjedhojë, këto kontrata nuk mund të konsiderohen të dokumentuara në përputhje të plotë me kërkesën specifike të përcaktuar për punët e realizuara në cilësinë e nënkontraktorit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “IDEAL CONSTRUCTION AND PROJECTION (I.C.P.)” sh.p.k. për kontratat e deklaruara si të realizuara në cilësinë e nënkontraktorit, konstatohet se këto kontrata paraqesin mangësi dokumentare në raport me kërkesat e kriterit 2.3.1. Konkretisht, për kontratat e lidhura me “DYRRAKIUM CONSTRUCTION COMPANY” sh.p.k. dhe “PROGEEN” sh.p.k. rezultojnë të paraqitura kontrata ndërmjet subjekteve private, situacione dhe fatura, por nuk rezulton e paraqitur kontrata bazë ndërmjet kontraktorit kryesor dhe autoritetit kontraktor, si dhe nuk rezulton miratimi zyrtar i autoritetit kontraktor për ICP sh.p.k. si nënkontraktor. Në mungesë të këtyre dokumenteve, nuk provohet plotësisht statusi i operatorit si nënkontraktor i deklaruar dhe i miratuar, sikurse kërkohet shprehimisht nga kriteri.

Për rrjedhojë, këto kontrata nuk mund të përllogariten automatikisht si punë e ngjashme për efekt të përmbushjes së kriterit 2.3.1, pasi dokumentacioni i paraqitur nuk plotëson kushtet provuese të përcaktuara posaçërisht për eksperiencat e realizuara në nënkontraktim. Derisa të provohet me dokumentacionin e kërkuar kontrata bazë dhe miratimi zyrtar i autoritetit kontraktor, vlerat e këtyre kontratave nuk duhet të përfshihen në përllogaritjen e punëve të ngjashme të operatorit ekonomik.

Komsioni i vlerësimit të ofertave pas përlogaritjes së kontratave të tjera rezulton si më poshtë:

	Objekti	% e ICP	Vlera e realizuar pa TVSH që merret si bazë	Pjesa e ICP pa TVSH	
1	“Sistemi i trajtimit të ujërave të zeza në Lagjen e Re Spitallë”	BOE	10.10%	54,161,096.10 lekë	5,470,270.71 lekë
2	“Rehabilitim Kanali Gjorm”	BOE	8%	15,172,334.00 lekë	1,213,786.72 lekë
3	“Ndërtim i Rrjetit të Kanalizimeve në Fshatin Rrushkull”	Individualisht	100%	32,540,573.21 lekë	32,540,573.21 lekë
	TOTALI I ICP				39,224,630.64 lekë pa TVSH

Në rast të përlogaritjes sipas alternativës b) kërkesa do të ishte dyfishi i fondit limit në disa kontrata , pra **100,013,185 *200% =200,026,370*48 %** lekë pa TVSH, dhe në raport me pjesëmarrjen 48% të IDEAL CONSTRUCTION AND PROJECTION (I.C.P.)” sh.p.k. do të kërkohej një vlerë totale prej **96,012,657.6 lekë pa TVSH**, e realizuar në disa kontrata të ngjashme gjatë periudhës së kërkuar.

Përsa më sipër operatori ekonomik IDEAL CONSTRUCTION AND PROJECTION (I.C.P.)” sh.p.k nuk plotëson asnjë prej pikave të kriterit 2.3.1 të kapacitetit teknik, puna e ngjashme.

Ndodhur në këto kushte komisioni i vlerësimit të ofertave skualfikon bashkimin e operatorëve ekonomik.

Ne vlerësim të dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik IDEAL CONSTRUCTION AND PROJECTION (I.C.P.)” sh.p.k rezulton se ky operator ekonomik nga ndarja e punimeve ka marrë persiper të realizojë punime germimi dhe rezulton që nuk ka paraqitur licensen 2.III.B të kërkuar nga autoriteti kontraktor.

Theksjome faktin se AK harton kriteret e vecanta të kualifikimit me qëllim realizimin me sukses të punimeve, për të provuar që operatori ekonomik ka të gjithë kapacitetet ekonomike financiare , ekonomike dhe teknike për të realizuar kontratën.

Ne zbatim te nenit 88 te VKM Nr.285/2021 te prokurimit publik legjislacioni e ka te percaktuar qarte qe operatoret ekonomik hartojne dhe plotesojne kriteret e vecanata te kaulifikimit bazuar ne ndarjen e punimeve te cilet marrin persiper per te realizuar.

Persa me siper OE IDEAL CONSTRUCTION AND PROJECTION (I.C.P.)” sh.p.k shpk rezultlon se ka marr persiper punime germimi dhe transporti dherash per te cilat eshte e nevojshme disponimi i licenses se kerkuar nga AK, ndodhur ne keto kushte OE pjese e bashkimit te operatoreve nuk ploteson kriteret e vecanata te kualifikimit.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave për shkak të ekonomicitetit procedural ka vlerësuar të panevojshëm vijimin e verifikimit të dokumentacionit të operatorit ekonomik, duke qënë se përsëri statusi juridik i këtij operatori do të mbetet i s’kualifikuar.

Bazuar në Nenin 92 paragrafi 3 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar me Ligjin Nr.16 datë 08.02.2024 ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, **Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pranë Autoritetit Kontraktor bëri s’kualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomik shoqëria “IDEAL CONSTRUCTION AND PROJECTION (I.C.P) shpk me NIPT L91310511L dhe shoqëria “LIQENI VII” shpk me NIPT K01730502W.**

4. Bashkimi i operatoreve ekonomik

”Kevin Konstruksion”sh.p.k

K71401004W

“NIKA” sh.p.k

J76705047U

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Në vlerësim të dokumentacionit të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomik komisioni i vlerësimit të ofertave rezultlon si më poshtë:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga BOE “KEVIN KONSTRUKSION” sh.p.k. & “NIKA” sh.p.k., konkretisht Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të shoqërisë “NIKA” sh.p.k., kontratës së bashkëpunimit dhe preventivit të ndarë sipas përqindjes së pjesëmarrjes së anëtarëve të BOE-së, rezultlon se shoqëria “NIKA” sh.p.k. ka marrë përsipër

realizimin e 65% të punimeve objekt kontrate, përfshirë 65% të zërit nr. 28 “Pastrim tubi kanalizimesh DN/OD = 200÷600 mm” dhe 65% të zërit nr. 29 “Pastrim pusetash ekzistuese në rrjetin e K.U.Z.”. Kjo ndarje është e shprehur konkretisht në preventivin e paraqitur nga vetë BOE-ja.

Referuar Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të shoqërisë “NIKA” sh.p.k., në seksionin për disponimin e mjeteve/pajisjeve/makinerive, nuk rezulton i deklaruar një autobot teknologjik i pajisur me pompë vakumi dhe pompë presioni të lartë apo pajisje ekuivalente teknologjike të përshtatshme për pastrimin e tubacioneve të kanalizimeve dhe pusetave.

Në zbatim të nenit 88, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, të ndryshuar, në ofertën e një bashkimi operatorësh ekonomikë duhet të përcaktohet pjesa e punës që do të kryejë secili prej anëtarëve, ndërsa sipas pikës 3 të të njëjtit nen, kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe teknike duhet të përmbushen nga bashkimi në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim të përcaktuar në aktmarrëveshje.

Për rrjedhojë, në kushtet kur “NIKA” sh.p.k. ka marrë përsipër 65% të zërave nr. 28 dhe nr. 29, kjo shoqëri duhet të disponojë kapacitetet teknike që, për nga natyra dhe funksioni, bëjnë të mundur realizimin e pjesës së punimeve të marra përsipër.

Në mbështetje të dispozitave të legjisalcionit të prokurimit publik, konkretisht neni 77 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, lidhur me aftësinë teknike dhe profesionale të operatorëve ekonomikë, si dhe me nenin 39 të VKM nr. 285/2021, sipas të cilit, për kontratat e punëve publike, operatori duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet teknike të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Gjithashtu, në kuptim të nenit 82 të LPP-së, Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit përbën provë paraprake të përmbushjes së kriterëve, ndërsa dokumentacioni provues duhet të vërtetojë gjendjen faktike të operatorit në momentin e ofertimit. Për rrjedhojë, mungesa e një kapaciteti teknik të nevojshëm për realizimin e punimeve të marra përsipër nuk mund të konsiderohet një mangësi thjesht formale.

Në këto kushte, duke qenë se nga dokumentacioni i paraqitur nuk provohet se “NIKA” sh.p.k. disponon mjetet teknologjike të nevojshme për realizimin e 65% të zërave nr. 28 dhe 29, konstatohet se kapaciteti teknik i këtij anëtari nuk është në përputhje me përqindjen dhe natyrën e punimeve të marra përsipër në aktmarrëveshjen e BOE-së, në kundërshtim me nenin 88, pika 3, të VKM nr. 285/2021, nenin 77 të ligjit nr. 162/2020 dhe kriteret përkatëse të Dokumenteve të Tenderit. Për rrjedhojë, kriteri përkatës i kualifikimit konsiderohet i papërmbushur dhe oferta e BOE-së nuk kualifikohet.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave për shkak të ekonomicitetit procedural ka vlerësuar të panevojshëm vijimin e verifikimit të dokumentacionit të operatorit ekonomik, duke qënë se përsëri statusi juridik i këtij operatori do të mbetet i s'kualifikuar.

Bazuar në Nenin 92 paragrafi 3 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar me Ligjin Nr.16 datë 08.02.2024 ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, **Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pranë Autoritetit Kontraktor bëri s'kualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomik shoqëria “Kevin Konstruksion” Sh.p.k me NIPT K71401004W dhe shoqëria “Nika” Sh.p.k me NPT J76705047U.**

5. Operatori ekonomik

NDERGJONI”Sh.p.k

K31329048I

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “NDREGJONI” sh.p.k., me NIPT K31329048I, i cili ka paraqitur ofertë ekonomike në vlerën 65,006,001 lekë pa TVSH, rezulton se ky operator nuk ka paraqitur/dokumentuar licencën e kërkuar në pikën 2.3.4 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, konkretisht Licencën e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit, Kodi III.2.B – “Për grumbullim dhe transport të mbetjeve inerte”.

Kriteri i mësipërm është përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor si kërkesë e detyrueshme për kapacitetin teknik dhe profesional të operatorëve ekonomikë, në funksion të realizimit të punimeve objekt prokurimi. Përbushja e tij duhet të provohet nëpërmjet dokumentacionit përkatës të vlefshëm dhe në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Në rastin konkret, nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “NDREGJONI” sh.p.k., nuk rezulton disponimi i licencës me kodin III.2.B, të kërkuar shprehimisht në pikën 2.3.4. Për rrjedhojë, operatori ekonomik nuk provon se disponon autorizimin/licencimin e nevojshëm për ushtrimin e veprimtarisë së grumbullimit dhe

transportit të mbetjeve inerte, veprimtari e cila është konsideruar nga Autoriteti Kontraktor e nevojshme për zbatimin e kontratës.

Mungesa e kësaj licence nuk përbën një mangësi formale apo element që mund të konsiderohet i parëndësishëm, por lidhet drejtpërdrejt me plotësimin e një kriteri kualifikues të përcaktuar në dokumentet e tenderit. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave është i detyruar të vlerësojë operatorët ekonomikë mbi bazën e kërkesave të publikuara dhe të zbatuara në mënyrë të njëjtë për të gjithë pjesëmarrësit, pa mundur të konsiderojë të plotësuar një kriter për të cilin nuk është paraqitur dokumentacioni provues i kërkuar. Për sa më sipër, Komisioni konstaton se operatori ekonomik “NDREGJONI” sh.p.k. nuk përmbush kriterin e përcaktuar në pikën 2.3.4 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, për shkak të mungesës së Licencës Kodi III.2.B “Për grumbullim dhe transport të mbetjeve inerte” dhe, si rrjedhojë, oferta e tij vlerësohet e pakualifikueshme / operatori ekonomik nuk kualifikohet për vijimin e mëtejshëm të procedurës.

Autoriteti Kontraktor gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt-prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për produktet që do të ofrojnë, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat e cilësisë. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave për shkak të ekonomicitetit procedural ka vlerësuar të panevojshëm vijimin e verifikimit të dokumentacionit të operatorit ekonomik, duke qënë se përsëri statusi juridik i këtij operatori do të mbetet i s`kualifikuar.

Bazuar në Nenin 92 paragrafi 3 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar me Ligjin Nr.16 datë 08.02.2024 ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, **Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pranë Autoritetit Kontraktor bëri s`kualifikimin e operatorit ekonomik shoqëria “NDREGJONI” sh.p.k., me NIPT K31329048I.**

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se operatorI ekonomik ‘**KRONOS KONSTRUKSION**’ SHPK me NIPT:K41416033P dhe Adrese: **Bulevardi Gjergj Fishta,, Prane ish ekspozites Shqiperia Sot, Tirane**, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej **92,891,281.35 { Nentedhjete e dy milion e teteqind e nentedhjete e nje mije e dyqind e tetedhjete e nje pike tridhjete e pese } Leke pa TVSH1** [shuma përkatëse e shprehur me fjalë dhe shifra] / totali i pikëve të marra **279** është identifikuar si ofertues i sukseshëm.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.

ADMINISTRATORI

Sulejman ISUFAJ